

SHËRBIMI I KUJDESTARISË NDAJ TË MITURVE JASHTË KUJDESIT PRINDËRORE DHE ROLI I SHTETIT SHQIPTAR

Ilda MELO, LL.M*

Abstrakt: *Të miturit për shkak të pamaturisë fizike dhe mendore kanë nevojë për një përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë të të drejtave të tyre. Janë prindërit që nëpërmjet ushtrimit të përgjegjësisë prindërore realizojnë të drejtat dhe përmbushin detyrimet e tyre, derisa ata të arrijnë moshën madhore, moshë kur ata mbajnë përgjegjësi të plotë për veprimet. Por ka raste kur të miturit mbeten jashtë këtij përkujdesi për faktorë natyrale, sociale apo ligjore. Mungesa e përgjegjësisë së të miturve në këto kushte ka detyruar ligjvënësin të kërkojë zgjidhje alternative për mbrojtjen e të drejtave të tyre.*

Kujdestaria është një ndër alternativat ligjore për të miturit jashtë përkujdesit prindëror për t'u rritur pranë një mjedisi familjar, nën kujdestarinë e një kujdestari, familje kujdestare apo institucioni publik apo privat. De facto dhe de jure ata zëvendësojnë prindërit e të miturit në ushtrimin e përgjegjësive prindërore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Koncepti i shërbimit të kujdestarisë së ofruar nga familja kujdestare përbën një risi për legjislacionin shqiptar. Nëpërmjet këtij studimi synohet të jepet një panoramë sociale e ligjore e këtij shërbimi që aplikohet për herë të parë në realitetin shqiptar, përmes paraqitjes së të dhënave zyrtare, kornizën ligjore sipas legjislacionin shqiptar si dhe rolin e shtetit në sigurimin e standardeve të këtij shërbimi, parë në kuadër të përafrimit me legjislacionin europian. Paraqitja e disa rasteve mbi zbatimin në praktikë të këtij shërbimi, disa sugjerime dhe rekomandime për të ardhmen përbëjnë pjesën e dytë dhe të fundit të këtij studimi.

Fjalë çelës: *Familje kujdestare, shërbim kujdestarie, shërbim, kujdestari, standarde.*

1. Hyrje

Të drejtat e njeriut, respektimi dhe mbrojtja e tyre në shoqërinë njerëzore në zhvillim dhe transformim tashmë përbëjnë parimet bazë mbi të cilin është ngritur korpusi ndërkombëtar i së drejtës. Midis tyre, së fundmi vihet re një theks gjithmonë e më i madh, i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si premisë parësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në standardet më të larta.

Mbrojtja e duhur e të drejtave të njeriut, në fakt, fillon me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të drejta që ligji iu njeh që në momentin e lindjes, por në pamundësi për ti ushtruar deri sa të bëhen madhore. Papjekuria fizike dhe mendore e të miturve për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryejnë dhe pasojat që vijnë si rezultat i tyre, determinon mungesën apo kufizimin e zotësisë për të vepruar, ose e thënë ndryshe mundësisë për ti ushtruar këto të drejta, deri në arritjen e moshës madhore. Janë prindërit natyralë të fëmijës ata të cilët nëpërmjet ushtrimit të përgjegjësisë prindërore mundësojnë realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre duke vepruar si përfaqësuesit ligjore të tij.

SHËRBIMI I KUJDESTARISË NDAJ TË MITURVE JASHTË KUJDESIT PRINDËRORE DHE ROLI I SHTETIT SHQIPTAR

Por shpesh herë mund të ndodhemi para situatave kur këto fëmijë ndodhen jashtë kujdesit prindëror, për shkak të pamundësisë të prindërve natyrale për të ushtruar përgjegjësinë prindërore. Arsyet mund të jenë arsye natyrore (kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur) arsye ligjore (u është hequr përgjegjësia prindërore apo zotësia për të vepruar) arsye sociale (pamundësia fizike apo financiare).

Mungesa e kujdesit prindëror dhe rrjedhimisht edhe të përfaqësuesit ligjor në marrëdhënie me të tretet rrezikon miturin në realizimin e të drejtave të tij dhe ajo që është më e rëndësishme rrezikon mundësinë tij për rritje dhe edukim në një mjedis familjar, e nevojshëm kjo për zhvillimin normal të personalitetit të tij.

Në realitetin shqiptar të pas viteve 90 ndodhemi gjithmonë e më shpesh para pasojave negative të shkaktuara nga fenomene sociale që përballet shoqëria shqiptare sot. Papunësia, varfëria e tejskajshme, veçanërisht në zonat rurale apo ato malore, emigracioni, konfliktet sociale në familje, divorcet, përbejnë disa nga fenomenet sociale të cilat kanë ndikuar negativisht në rritjen e numrit të fëmijëve të mbetur jashtë kujdesit prindëror. Kryesisht ata vendosen nën kujdesin informal të të afërmeve të tyre në rastin më të mirë, apo ndodhen të braktisur në rrugë të ekspozuar kështu ndaj kriminalitetit, dhe prostitucionit në rastin më të keq. Përmendim këtu rastin e tre fëmijëve nga Peshkopia të cilët jo më vonë se dy javë para u gjetën të braktisur nga prindërit e tyre pranë ndërtesës së spitalit të qytetit. Ishin punonjësit e spitalit ata që u dhanë ndihmën e parë dhe njoftuan organet e policisë për këtë rast. Pas gjetjes së prindërve të tyre kur ata u pyetën për arsyet e braktisjes, babai i fëmijëve përmendi, pamundësinë financiare për t'i rritur.

Shqipëria është një vend me popullsi me moshë të re në Europë ku 1/3 e popullsisë së saj janë fëmijë të grupmoshës 0-18. Pavarësisht nga treguesit ekonomike financiarë që sipas të dhënave zyrtare kanë qenë inkurajues, Shqipëria vazhdon të mbetet një nga vendet më të varfra të Europës dhe me një pabarazi të theksuar gjeografike, etnike dhe në të ardhura. Sipas vëzhgimit të Matjes së Standardeve të Jetesës vlerësohet se 216.800 fëmijë jetojnë nën nivelin e varfërisë ku në një masë të konsiderueshme janë të miturit jashtë kujdesit prindëror. Nuk kemi të dhëna të sakta lidhur me numrin e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror të cilat ndodhen në kujdesin informal. Pjesa më e madhe e tyre janë nën kujdesin e të afërmeve të tyre, të cilët kujdesen de fakto për të miturit, pa pasur kujdestarinë ligjore mbi ta. Një pjesë tjetër e tyre si rezultat i migracionit të pakontrolluar të popullsisë nga zonat malore në zonat e populluara urbane, rezultojnë të jenë ende të paregjistruar në zyrat e gjendjes civile. Rrjedhimisht këto kategori nuk mund të përfitojnë nga shërbimet sociale të ofruara.

Në lidhje me kujdesin e të miturve në sistemin formal, Shërbimi Social Shtetëror vlerëson se në vitin 2004 ishin 1198 fëmijë të privuar nga kujdesi prindëror të përfshirë nën kujdesin e sistemit formal: 448 fëmijë ishin në institucione rezidenciale publike, ndërsa pjesa e mbetur ishte nën kujdesin e organizatave jofitimprurëse. Të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2008 tregojnë se kemi një rënie të lehtë të numrit të fëmijëve të vendosur në këto institucione me 1086

fëmijë nga të cilët 581 fëmijë janë në institucione rezidenciale publike, ndërsa pjesa e mbetur janë nën kujdesin e 17 organizatave jofitimprurëse.

Në krahasim me vende të tjera të rajonit, Shqipëria ka një numër të vogël fëmijësh që jetojnë në institucione rezidenciale, por dukuria ka prirje në rritje, ndërkohë që kanë ndryshuar edhe kategoritë e fëmijëve. Më 1994 numri i fëmijëve në kujdes rezidencial ishte rreth 400 dhe shumica e tyre ishin fëmijë të braktisur qysh prej lindjes dhe jetimë biologjikë. Të dhënat në vitin 2004 apo dhe 2008 tregojnë se numri i fëmijëve në institucionet e kujdesit për fëmijë është rritur tri herë në krahasim me vitin 1994 dhe se shumica e fëmijëve janë "jetimë socialë"¹ dhe "fëmijë me probleme sociale".

2. Korniza ligjore e shërbimit të kujdestarisë

Rritja e numrit të të miturve jashtë kujdesit prindëror si dhe problematikave sociale që ky fenomen mbart, detyron ligjvënësin shqiptar dhe strukturat ekzekutive në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të përkujdesjes sociale. Bazuar tek parimi i interesit më të lartë të fëmijës, Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës, që mund të cilësohet si një kod universal për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, thekson marrjen masave të përshtatshme vendimmarrëse ekzekutive dhe administrative për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror. Sipas nenin 20 të konventës *“Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.*

Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, inter alia, formën e vendosjes në një familje, të “Kafalasë” sipas të drejtës islamike, të birësimit ose, në rast nevojë, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët.

Ligjvënësi shqiptar e ka zbatuar këtë parim nëpërmjet parashikimeve ligjore në legjislacion duke filluar nga dispozitat kushtetuese. Ne nenin 54 dhe 59 të Kushtetutës së Shqipërisë parashikohet sigurimi i një mbrojtjeje te veçantë për kategoritë sociale ne nevojë si nënat apo dhe fëmijët, te moshuarit etj. Ligjvënësi shqiptar ka gjetur kujdestarinë midis formave të tjera alternative të përkujdesjes siç është adoptimi, si një zgjidhje ligjore për mbrojtjen dhe përfaqësimin e të miturve në marrëdhënie me të tretët. Rregullimi ligjor i këtij instituti trajtohet në dispozitat e kodit të familjes dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kodi i ri i Familjes i viti 2003 sjell një sërë risish lidhur me sistemin e kujdesit social ndaj të miturve jashtë kujdesit prindëror në Shqipëri. Midis tyre përmendim futjen për herë të parë të shërbimit të kujdestarisë për të miturit jashtë kujdesit prindëror në familje kujdestare, si një ndër format e kujdestarisë ligjore.

¹ Jetime socialë konsiderohen të miturit jashtë kujdesit prindëror, prindërit e tyre natyrore të të cilëve jetojnë, por për arsye fizike apo financiare nuk kanë mundësi të kujdesen për ta.

*Koncepti i Familjes Kujdestare*² gjithashtu, është një koncept i ri i futur në legjislacionin shqiptar (neni 266 i KF) si një familje alternative nga ajo e origjinës për të miturve jashtë kujdesi prindëror. Në kuptim të ligjit (neni 266 i KF) familja kujdestare përkufizohet si **“një familje alternative e vendosur nga gjykata për ti ofruar fëmijës një mjedis familjar kushte për mirërritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale”**. Vendosja e të miturit në një familje anëtarët e të cilëve nuk kanë lidhje gjaku apo gjinie me të mitur mund të përbëjë ambientin e duhur familjar për rritje dhe edukim për aq kohë sa familja apo prindërit e tyre të zgjidhin problemet.

Kjo formë përkujdesje në çdo rast është një zgjidhje ligjore temporale, e aplikueshme kryesisht për fëmijët që jetojnë pranë familjeve me probleme sociale. Në kuadër të zbatimit të masave ligjore emergjente, (neni 288-300 KF) largimi i përkohshëm i fëmijës nga këto familje, pas gjykimit nga organet kompetente, i shërben mbrojtjes më të mirë të interesave të tij.

Por duke pasur parasysh se familja natyrale është ambienti më i mirë familjar për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, kjo formë alternative e përkujdesjes që ofron përkohësisht ambientin familjar dhe mbështetjen emocionale për të miturit ka si qëllim parësor përgatitjen e fëmijës drejt rikthimit të tij në familjen e origjinës, në momentin kur kjo familje ka arritur të zgjidhë problemet që kanë shkaktuar pamundësinë e përkujdesjes ndaj të miturit.

Nëse kjo nuk është e mundur, kjo formë kujdestarie do të shërbejë si zgjidhje e përkohshme, deri në një zgjidhje permanente, si mund të jetë birësimi i të miturit, vendosja e tij nën kujdestarinë e të afërmeve apo dhe përgatitja për jetesën e pavarur me arritjen e moshës madhore. Një fëmijë, megjithëse në pamundësi për tu rritur nga ati dhe nëna biologjike ka nevojë për modelin e këtyre dy figurave për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit të tij.

Parë në **këndvështrim historik** mund të themi se kujdestaria ndaj të miturve është cilësuar si “mirësia e të huajve“. Kujdestaria informale ka qenë tradicionalisht e praktikuar nga keltet dhe popullsia nordike të cilët mendonin se kështu mund t’i shpëtonin fëmijët nga sulmet armiqësore. Forma më formale e kujdestarisë së paguar privatisht u praktikua në Gjermani në shek. XI-XII nga familjet e pasura që i linin fëmijët e tyre nën kujdesin e të afërmeve ose të huajve³.

Rastet e para të kujdestarisë formale shënohen në Francë në vitet 1450 dhe i referohet fëmijëve që u zhvendosen në rezidencat e murgeshave nëpër fshatra. Murgeshat i mbanin fëmijët të paktën deri në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Ky sistem, u huazua edhe në Britani ku u quajt “Foundling Hospitals of London & Glasgow”. Në ndryshim nga Franca, Britania e Madhe sugjeroi një praktikë fillestare për fëmijët 4-6 vjeç nga ku pas kalimit të kësaj faze, këta fëmijë dilnin si çirakë.

² Neni 266 I KF: “*Familja kujdestare është një familje alternative e vendosur nga gjykata, për ti ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte mirërritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale*”.

³ Boswell 1991.

Ky sistem me përzgjedhje dhe pagesë u prezantua konkretisht në Irlandë në vitin 1832 (u prezantua pikërisht në Irlandë për arsye fetare) dhe më pas në Skoci. Kujdestaria pranë familjeve kujdestare me pagesë si formë e këtij tipi ishte më e preferuar sesa institucionalizimi sepse nuk siguronte asnjë lloj rritjeje të tipit familjar⁴. Autoritetet në Skoci, e panë kujdestarinë si angazhim dhe përkujdesje nga ana e kujdestarëve. Kjo e fundit, filloi të praktikohet edhe pas Luftës së Dytë Botërore me teknikat e plota të kujdestarisë së përkohshme.

Në Shqipëri në fakt nuk kemi ndonjë eksperiencë të mirëfilltë lidhur me vendosjen e të miturve nën kujdestarinë e familjeve kujdestare. Këtu ka ekzistuar forma popullore, kryesisht informale, të kujdestarisë nga të afërmit e të miturve të ngelur jashtë kujdesit prindëror, kjo edhe për shkak të traditave zakonore të trashëguar veçanërisht në zonat malore të vendit. Gjithashtu përmendim edhe format e kujdestarisë pranë institucioneve publike apo private të përkujdesjes. Aktualisht janë shtuar format e përkujdesjes të parashikuara në legjislacionin shqiptar, kjo për të qenë sa më fleksibël ndaj nevojave dhe tipareve të personalitetit të të miturit të ngelur jashtë ambientit familjar, si kujdestaria pranë të afërmeve, kujdestaria pranë familjeve kujdestare, kujdestaria në komunitet e organizuar në formën e shtëpive familje (Fshati sos), forma e kujdestarisë në qendrat e kujdesit ditor (disa ore në ditë, kjo kryesisht si përkrahje për familjet në nevojë) kujdestaria rezidenciale pranë institucioneve publike apo private të përkujdesjes etj.

Midis formave të lartpërmendura, shërbimit të kujdestarisë pranë familjeve kujdestare po i jepet një prioritet gjithmonë e më i madh nisur dhe nga vetë avantazhet që mbart krahasuar me format e përkujdesjes nga të afërmit dhe sidomos të përkujdesjes institucionale. Përmendim këtu avantazhe të tilla si:

- Plotësim më i mirë i nevojave primare, fiziologjike (ushqim, strehim, veshmbathje etj);
- Largimi i fëmijën nga institucionalizimi, faktor që ndikon negativisht në përjashtimin social të të miturve;
- Përfshirja e familjes së origjinës në mbështetje e të miturit, inkurajimi i vizitave të prindërve dhe stimulimi i integritetit të tij në shoqëri.
- Ofrimi i ndihmës së duhur që fëmija të kapërcejë vështirësi emocionale apo të sjelljes të shkaktuara si rezultat i jetesës në familje me probleme sociale. Duhet pasur parasysh se familjet kujdestare trajnohen paraprakisht për të menaxhuar situata të tilla, ndërkohë që të afërmit e fëmijës dhe aq më pak institucionet e përkujdesit dështojnë në dhënien e kësaj ndihme.

⁴ Daven Port 1889.

- Sigurimi i kujdesit, marrëdhëniet të qëndrueshme, të besueshme për fëmijën duke promovuar identitetin dhe vetëvlerësimin e kapaciteteve për të formuar lidhje efikente ose kapërcim i vështirësive dhe problemeve.
- Bashkëpunim me shërbimet sociale në mënyrë që të përgatitin fëmijën për rikthim në familje, adoptim ose pavarësi kur ka mbushur kriterin moshë janë disa avantazhe të tjera krahasuar ne format e tjera të kujdestarisë.

Në realitetin shqiptar ky lloj shërbimi është në fazë eksperimentale. Në aspektin ligjor është krijuar një bazë e mirë ligjore nëpërmjet parashikimeve në kodin e familjes, por duhet të themi që parashikimet pavarësisht se inovative ngelen gjenerike në rregullimin ligjor të këtij shërbimi. Themi këtë pasi nuk ka ende detajime lidhur për format mjetet dhe procedurat që duhen ndjekur për evidentimin e familjeve kujdestare, evidentimin e nevojave të fëmijës, standardet e shërbimit, dhe procedurat e monitorimit të tij.

Kodi i Familjes në nenin 266, paragrafin 2 dhe 3 të tij, vetëm përcakton se është sektori i ndihmës dhe përkrahjes sociale pranë bashkisë apo komunës organi i cili ka për detyrë evidentimin e familjeve kujdestare që mbi bazë të deklarate gatishmërie paraqesin kërkesën për marrjen e kujdestarisë së të miturit. Mendimi i këtij organi merret parasysh nga gjykata për vendosjen e të miturit në kujdestarinë e familjes kujdestare. Aktualisht sfida e ligjvënësit shqiptar është plotësimi i paketës ligjore e cila do ta mund të siguronte bazën e nevojshme për implementimin e kësaj forme alternative përkujdesje.

3. Roli i shtetit shqiptar për ofrimin e këtij shërbimi

Me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim–Asocimit (MSA) nënshkruar në qershor 2006 me Bashkimin Europian, që përfaqëson edhe kuadrin strategjik të hartimit të politikave ekonomike dhe sociale, qeveria shqiptare hartoi dhe miratoi Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritit. Pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe strategjia Sektoriale e Mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”. Dokumenti i Politikave për Kujdestarinë e Fëmijëve në nevojë, në këtë drejtim vë theksin në promovimin dhe implementimin e formave të reja alternative të përkujdesjes ndaj të miturve jashtë kujdesit prindëror siç është dhe vendosja e të miturve nën kujdestarinë e familjeve kujdestare⁵.

Shërbimi i Kujdestarisë në thelb përbën ofrimin e një mbrojtje të veçantë nga shteti për fëmijët e mitur, kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtuar përgjegjësinë prindërore.

Suksesi i këtij shërbimi qëndron në bashkëpunimin e mirë-koordinuar të aktorëve të drejtpërdrejtë të tij: i mitur, Familje e origjinës, dhe familje kujdestare. Që ky bashkëpunim të funksionojë në interes të plotësimit të nevojave të të miturit, është i nevojshëm roli koordinues, monitorues dhe kontrollues aktorëve indirekte të këtij shërbimi, ofruesve të shërbimit të

⁵ Vendimi i Këshillit të ministrave nr. 1104, datë 30.07.2008 “ Për disa shtesa në vendimin nr 80 datë 28.01.2008 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, Kapitulli 6 “Dokumenti i Politikave për Kujdestarinë e Fëmijëve në nevojë”.

SHËRBIMI I KUJDESTARISË NDAJ TË MITURVE JASHTË KUJDESIT PRINDËRORE DHE ROLI I SHTETIT SHQIPTAR

kujdestarisë dhe gjykatës. Edhe në këtë drejtim eksperiencia shqiptare nuk ka shumë për të thënë. Duke iu referuar eksperiencës së vendeve ku implementohet ky shërbim, përmendim si të tilla, zyrat apo departamente të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë /komunës, qendra sociale në nivel komunitar, organizata apo agjenci të licencuara për ofrimin e këtij shërbimi, dhe gjykata e të miturve në vendbanimin e të miturit.

Parashikohet që struktura të tilla të ngjashme në nivel lokal se bashku me Inspektoratin shtetëror të shërbimeve sociale, ministria e financës dhe ministria e punës, çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta në nivel qendror të mundësojnë realizimin e procedurës së duhur ligjore për vendosjen e të miturit në kujdestarinë e familjes kujdestare.

Përzgjedhja e familjeve kujdestare do të bëhet sipas kritereve dhe standardeve të mirëpërcaktuara në rregullore, në funksion të plotësimit të nevojave të të miturit dhe tiparet e personalitetit të tij. Këto institucione do të jenë përgjegjëse edhe për administrimin e mëtejshëm të shërbimit të kujdestarisë pas vendosjes së të miturit pranë familjes kujdestare sipas një skeme veprimi të planifikuar në detaje.

Kohëzgjatja e Shërbimit të kujdestarisë, pra sistemimi i fëmijës në familje kujdestare sipas nevojës së rastit mund të jetë për:

një periudhë afatshkurtër, sistemim i cili nuk zgjat më shumë se 12 muaj, ***afatgjatë***, sistemim i cili mund të zgjasë nga 12 muaj deri kur fëmija arrin moshën e pjekurisë dhe ***sistemimi emergjent*** si rezultat i largimit të menjëhershëm të fëmijës nga familja e origjinës kur vlerësohet se është në interesin më të lartë të fëmijës, kjo në përputhje me përcaktimet ligjore për masat emergjente (nenet 281-300 KF).

Bëhet fjalë për raste të tilla kur fëmija ka qenë viktimë e krimeve në familje, si dhunimi i fëmijës nga prindi, rastet e incesteve në familje, apo raste kur fëmijët kanë asistuar në kryerjen e dhunimeve të familjareve të tjerë, rasti i vrasjes së nënës nga babai i fëmijës etj.

Parashikimi i sistemit të monitorimit dhe kontrollit të shërbimit të kujdestarisë në familje kujdestare përbën plotësimin e një boshllëku në legjislacion shqiptar të cilit deri tani i ka munguar sistemi i monitorimit dhe kontrollit të kujdestarisë në të gjitha format e saj. Parashikohet që kontrolli dhe monitorimi si elementë të nevojshëm të procesit në funksion të sigurimit të mirëqenies të fëmijëve, do të jetë detyrë e “ofruesit të shërbimit të kujdestarisë”. Ai mund të jetë zyra e ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë/komunës, agjencitë e kontraktuara për ofrimin e këtij shërbimi në nivel lokal, dhe inspektorati i SHSSH me qendrat e tij rajonale në bashkëpunim në pushtetin lokal në nivel qendror dhe rajonal.

Monitorimi do të kryhet nëpërmjet disa formave, si ndjekjen periodike (çdo 2 javë 1/muaj/ çdo 6 muaj) e shërbimit të kujdestarisë nga punonjësit sociale pranë sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale si dhe takimeve vlerësuese që organizohen pas muajit të parë të vendosjes së të miturit pranë familjes kujdestare. Ato kanë për qëllim, vëzhgimin e nivelit të përmbushjes së

nevojave të fëmijës, ofrimin e një mbështetjeje psiko-sociale për familjen kujdestare dhe anëtarët e saj si dhe për fëmijën e vendosur në kujdestari.

4. Disa sugjerime në funksion të përmirësimit të shërbimit të kujdestarisë

Që ky proces t'ia arrijë qëllimit, zëvendësimit përkohësisht dhe në nivele optimale të një ambienti familjar për mirëritje edukimin, zhvillimin normal të personalitetit të miturit, duhen ndërmarrë ndryshime ligjore në legjislacionin aktual si dhe masave administrative pasuese. Parashikimi i procedurave të ankimimit ndaj aktorëve që janë pjesë e këtij shërbimi, fëmijët, familjet biologjike apo familjes kujdestare si dhe çdo person i tretë që vepron në emër të fëmijës pranë ofruesit të shërbimit dhe më tej në gjykatë apo prokurori përbën një element sigurie për të miturit ndaj abuzimeve apo shkeljeve të të drejtave të tyre. Ky shërbim nuk do të mund të realizohet pa mbështetjen financiare të shtetit apo ofruesve private të këtij shërbimi. Do të ishte e këshillueshme që ministria e financave mbi bazë të kërkesave të paraqitura nga strukturat e pushtetit lokal që kanë për detyrë implementimin e këtij shërbimi, të planifikojë në fillim çdo viti një zë të veçantë në buxhetin e shtetit për këtë shërbim të ri. Aktualisht nuk është miratuar një pagesë për familjet kujdestare, dhe kjo rrezikon suksesin e këtij shërbimi.

Konkretisht sugjerojmë si të nevojshme ndërhyrjen në Ligjin nr. 9355, datë 10 mars 2005, “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore” nëpërmjet një shtese në nenin 17, duke përfshirë përveç shërbimit të ofruar nga qendrave rezidenciale edhe atë të ofruar nga familjet kujdestare, si pjesë të sistemit të shërbimeve të përkujdesjes sociale për të cilat shteti ka për detyrë të sigurojë mbështetjen financiare të nevojshme. Gjithashtu mendoj se është e nevojshme miratimi i një akti ligjor i veçantë për kujdestarinë e të miturve i shoqëruar me një rregullore mbi zbatimin e shërbimit të kujdestarisë bazuar të prioritetet e përcaktuara në strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe plani i zbatimit të saj.

Në përfundim duhet të themi se aplikimi i këtij shërbimi duke qenë në fazën e tij eksperimentale ende nuk është shtrirë praktikisht si një shërbim i mirëfilltë social. Nga shqyrtimi i praktikës gjyqësore rezulton se ende nuk kemi vendime gjyqësore të vendosjes së të miturit pranë një familjeje kujdestare. Duke pasur parasysh se gjyqtari luan një rol vendimtar në lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve midis subjekteve të kujdestarisë, profesionalizmi i tij në vlerësimin e rrethana konkrete për marrjen e vendimit të duhur, duhet të jetë në standardet më të larta. Në këtë drejtim sugjerojmë se janë të nevojshme edhe ndryshime të sistemit gjyqësor në funksion të mbrojtjes së të drejtave të të miturit. Krijimi i gjykatave të të miturve apo gjykatave të kujdestarisë me gjyqtarë të trajtuar në këtë drejtim do të ishin më të përshtatshme në trajtimin e çështjeve të tilla delikate dhe me efëciente në arritjen e qëllimit, sigurimin e të drejtave të fëmijës sipas interesit të tij më të lartë.

Tendencat ligjore tregojnë rëndësinë që po i kushtohet rolit administrues të ofruesit të shërbimit të kujdestarisë në veçanti punonjësit sociale që do të ndjekë nga afër gjendjen e fëmijës dhe familjes gjatë ofrimit të shërbimit. Sugjerojmë se është e nevojshme marrja e masave

SHËRBIMI I KUJDESTARISË NDAJ TË MITURVE JASHTË KUJDESIT PRINDËRORE DHE ROLI I SHTETIT SHQIPTAR

administrative për rritjen e profesionalizmit të punonjësve sociale si esenciale për impaktin pozitiv që do të ketë ky shërbim në rritjen dhe zhvillimin normal të të miturve jashtë kujdesit prindëror. Struktura e zyrave të ndihmës dhe shërbimeve sociale ka nevojë gjithashtu për një riorganizim në funksion të këtij shërbimi. Ngritja e një grupi multidisiplinar i përbërë nga punonjës sociale, psikologë, mjekë, edukatorë etj, në formën e një bordi kujdestarie do t'i shërbente më së miri procesit të administrimit dhe kontrollit të shërbimit të kujdestarisë.

BIBLIOGRAFI

Vlerësimi i shërbimit të kujdesit ndaj fëmijës dhe i institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror, Raport studimor i financuar nga UNICEF, Shqipëri, Tetor 2005.

Të dhëna zyrtare statistikore nga Shërbimi Social Shtetëror, 2008.

Raport i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës mbi zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 nëntor 1989 dhe ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar në vitin 1992.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar në vitin 1998.

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, viti 2003.

Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1104, datë 30.07.2008 “ Për disa shtesa në vendimin nr 80 datë 28.01.2008 të këshillit të ministrave “ Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

Udhëzim i Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Nr. 830, datë 14.4.2008 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike”, standarde janë përcaktuar në VKM nr 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”.